



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 13.03.2026

V E N D I M

Nr. 8, datë 13.03.2026

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI MASAT ORGANIZATIVE DHE TEKNIKE
PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 13 mars 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- “Miratimin e rregullores “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike””

BAZË LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 56, pika 3/b e nenit 148, si dhe pika 10 e nenit 157 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projektregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
2. Qëndrimi i AKEP, për komentet e palëve të interesuara pas këshillimit publik;
3. Projektvendimi i arsyetuar;
4. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 24, datë 03.11.2025, ka miratuar dokumentin për këshillim publik, Projektregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
2. Dokumenti për këshillim publik “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, përmbante propozimin e AKEP për projektregulloren e re, që do të shfuqizojë rregulloren nr. 37, datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, në fuqi, do të reflektojë përcaktimet e neneve 54, 56, 148 dhe 157 të ligjit nr. 54/2024, mbi sigurinë e rrjeteve, marrjen dhe zbatimin e masave teknike dhe organizative për të parandaluar dhe ulur ndjeshëm ndikimin e aksidenteve të sigurisë.
3. Projektregullorja synon të harmonizohet me standardet e Direktivës së BE 2022/2555 (NIS2) e cila përfaqëson praktikën më të mirë evropiane në fushën e sigurisë kibernetike. Nenet 21–23 të NIS2 përmbajnë detyrime specifike mbi masat e sigurisë kibernetike dhe raportimin e incidenteve, të cilat janë marrë parasysh në hartimin e kësaj projektregullore si dhe përcaktimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të pajtimtarëve, bazuar në legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.
4. Procesi i këshillimit publik për projektregulloren “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, u zhvillua për një periudhë 30-ditore, nga data 04.11.2025-03.12.2025.
5. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, pranë AKEP janë depozituar komente nga palë të interesuara, konkretisht:
 - në rrugë elektronike më datë 02.12.2025, nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Zyra e Komisionerit);
 - në rrugë elektronike, më datë 02.12.2025, nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a.;
 - me shkresën nr.1730 prot AKEP, datë 04.12.2025 nga sipërmarrësi “One Albania” sh.a.
6. Në përfundim të procesit të këshillimit publik dhe në vijim të komenteve të ardhura, me qëllim

diskutimin dhe qartësimin përcaktimeve të reja të projektregullores “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, AKEP, ka realizuar një takim me përfaqësues teknik të sipërmarrësve “Vodafone Albania” sh.a., dhe “One Albania” sh.a., në përfundim të të cilit, ka përgatitur:

- Projektregulloren “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, që përbën dokumentin përfundimtar pas procesit të këshillimit publik, si dhe
 - Qëndrimin e AKEP mbi komentet e palëve të interesuara.
7. Projektregullorja ka pësuar disa shtesa dhe ndryshime në raport me dokumentin e miratuar për këshillim publik, me vendim nr. 24, datë 03.11.2025, të Këshillit Drejtues të AKEP, të cilat janë pasqyruar në nenet 6, 7, 8, 10,11 si dhe në Aneksat 2 dhe 3, që i bashkëngjiten kësaj projektregullore.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” si dhe Qëndrimin e AKEP mbi komentet e palëve të interesuara, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim dhe dokumentet e miratuara në pikën 1 të tij, publikohen në faqen zyrtare të internetit www.akep.al.
3. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka